

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6640  
E hënë, 27 qershor 2022  
çmimi 0.40

Kadetët e FSK-së  
stërviten përkrah  
ushtarëve të NATO-s | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## TËRNOVCI I MADH 'MBAN PENG' PËRBËRJEN E KUVENDIT TË SERBISË



Përbërja e ardhshme e Kuvendit të Serbisë varet nga një fshat i vogël në jug të këtij vendi. Gati tre muaj pas zgjedhjeve parlamentare, rezultatet nuk dihen ende, për arsye të përsëritjes së votimeve në fshatin Tërnovci i Madh i Bujanocit si pasojë e disa parregullsive. Banorët atje do të dalin sërish

në vendvotime më 30 qershor, në përpjekjen e pestë. Nga votat e tyre varet nëse përfaqësuesit e pakicës shqiptare në Serbi do ta fitojnë mandatin e vetëm në Kuvend. Të drejtë vote në vendvotimin në Shkollën Filllore "Muharrem Kadriu" kanë 1 089 votues

### AKTUALE



G7 PARALAJMËRON NDALESË NË  
ARIN RUS F. 2

KUSH I KONTROLLON THIKAT  
NË SHKOLLA? F. 3

RUKIOI: QEVERIA KURTI  
PO HEZITON TA PRANOJË KRIZËN  
EKONOMIKE NË KOSOVË F. 7



### EKONOMI



PROJEKTI QË MUND  
TA PËRAFROJË EKONOMIKISHT  
KOSOVËN E SHQIPËRINË F. 7

### SPORT



MORINA: UDHËTOJMË  
PËR FITORE NË DANIMARKË F. 9

Përdoruesit e drogave  
trajtohen në Psikiatri,  
Kosova s'ka institut  
për trajtimin e varësisë

FAQE 6



ASOCIACIONI I KOMUNAVE DO T'I  
PADISË MASHTI-N DHE MSH-NË

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## G7 paralajmëron ndalesë në arin rus

LONDËR, 26 QERSHOR - Liderët e grupit të shtatë vendeve më të industrializuara (G7) do të mbledhen për një samit dyditor në Gjermani. Ky grup përbëhet nga Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca, Italia, Kanadaja dhe Japonia. Liderët e këtyre shteteve pritet të bëjnë ndalesë të re në importet e arit rus me qëllim të ashpërsimit të sanksioneve ndaj Rusisë për shkak të nisjes së luftës në Ukrainë. Rusët e pasur kanë blerë sasi të konsiderueshme të arit së fundi me qëllim të uljes së ndikimit të sanksioneve ndërkombëtare për shkak të

pushtimit rus në Ukrainë që ka nisur më 24 shkurt, ka thënë qeveria britanike përmes një deklaratë. “Këto masa do t’i godasin drejtpërdrejt oligarkët rusë dhe do ta godasin zemrën e makinerisë së luftës të presidentit rus Vladimir Putin”, ka thënë kryeministri britanik Boris Johnson. Londra ka thënë se eksportet ruse të arit kanë kapur vlerën e më shumë se 15 miliardë dollarëve vitin e kaluar. Ndalesa pritet të bëhet më 27 qershor dhe do të zbatohet shpejt. Ky vendim do të zbatohet për arin e nxjerrë nga toka, si dhe atë të rafinuar, kanë thënë

zyrtarët.

Presidenti amerikan Joe Biden ka shkruar në “Twitter” se ndalesa në arin rus përbën një tjetër “kosto të pashembullt për Putinin në mënyrë që t’i ndalohen fondet që i duhen për ta financuar luftën kundër Ukrainës”.

Bideni e ka quajtur arin si “eksport masiv që siguron dhjetëra miliarda dollarë për Rusinë”.

Liderët e G7-s do t’i nisin takimet më 26 qershor në rajonin e Bavarisë në Gjermani dhe do të vazhdojnë me samitin e NATO-s që mbahet më 29 qershor në Madrid, Spanjë.



## Bideni nënshkruan ligjin për kontroll të armëve

WASHINGTON, 26 QERSHOR - Presidenti amerikan Joe Biden e ka shndërruar në ligj një dokument dypartiak për armët, që përbën reformën më të madhe federale në tri dekadat e fundit, disa ditë pasi Gjykata Supreme ka zgjeruar të drejtat për armët. “Kjo është ditë madhështore”, ka thënë Bideni në Shtëpinë e Bardhë. “Me dëshirën e Zotit, ky ligj do të ruajë shumë jetë”. Gjykata Supreme ka deklaruar për herë të parë se Kushtetuta amerikane mbron të drejtën e një individi për të mbajtur armë në publik për vetëmbrojtje.



Vetëm në vitin 2020 kanë vdekur mbi 45 000 amerikanë nga armët, qofshin duke u vrarë apo vetëvrarë. Ky ka

qenë viti me shifrën më të lartë të viktimave të tilla, i regjistruar në historinë amerikane.

Kontrolli i armëve është kthyer tash e një kohë në çështje që krijon ndasi në Shtetet e Bashkuara, pasi shumë tentime për ta kontrolluar shitjen e tyre kanë dështuar njëra pas tjetrës.

Legjislacioni i ri përfshin provizione për t’iu ndihmuar shteteve që të mbajnë armët larg duarve të atyre që konsiderohen të rrezikshëm si dhe ta bllokojë shitjen e armëve për ata që janë dënuar për abuzime me partnerë të pamartuar.

Legjislacioni nuk ndalon shitjet e pushkëve apo karikatorëve me kapacitet të

lartë.

Për herë të parë me ligj parashihet që të bëhen kontrole për të kaluarën e një të mituri para se të blihet një armë, si dhe ky dokument shënjestron blerësit që kanë qenë të dënuar në të kaluarën për dhunë familjare.

Bideni ka përsëritur kritikën për vendimin e marrë nga Gjykata Supreme të premtën, e cila ka eliminuar të drejtën kushtetuese për abort. Ai ka thënë se administrata e tij do të fokusohet te vendet që do të zbatojnë këtë vendim dhe të sigurohet se ato nuk do t’i shkelin ligjet e tjera.

## Litania kritikohet për trajtim diskriminues të refugjatëve

VILNIUS, 26 QERSHOR - Qasja mikpritëse e refugjatëve ukrainas është krejtësisht ndryshe me mënyrën si janë trajtuar refugjatët nga Lindja e Mesme, të drejtat e të cilëve injorohen kur ata të hyjnë në Lituanë përmes Bjellorusisë, ka thënë Organizata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Amnesty

International. Refugjatët nga shtetet sikurse Iraku dhe Siria përballen me trajtim jonjerëzor, abuzime dhe dëbime ilegale, ka thënë organizata, duke cituar një sondazh të realizuar me migrantë nga dy qendra lituaneze ndalimi. Amnesty ka akuzuar, po ashtu, Bashkimin Evropian për

injorim të situatës në këtë vend anëtar. “Autoritetet lituaneze kanë mbajtur mijëra persona, për muaj të tërë, në qendra ndalimi, nën kontroll ushtarak, dhe aty janë përballur me torturë dhe abuzime të tjera”, është thënë në raportin e organizatës. “Atyre është duke iu mohuar qasja në procedura të azilit, në mënyrë që ata të



kthehen ‘vullnetarisht’ në shtetet prej të cilave kanë ikur”. Litania, ashtu sikurse

autoritetet evropiane, kanë akuzuar liderin autoritar bjellorus Aleksandr Lukashenka, që me qëllim ka bartur migrantë nga Lindja e Mesme drejt kufijve me vendet anëtare të bllokut evropian.

Kriza kufitare pati arritur pikun në fund të verës vitin e kaluar, pasi mijëra migrantë kanë tentuar të depërtojnë në BE.

## Talibanët paralajmërojnë për rrezik të sëmundjeve pas tërmetit vdekjeprurës

Kabul, 26 qershor - Zyrtarët shëndetësorë në qeverinë e udhëhequr nga talibanët në Afganistan kanë paralajmëruar më 26 qershor se mijëra njerëz të prekur nga tërmeti vdekjeprurës këtë javë, kanë nevojë të madhe për ushqime dhe ujë të pijshëm, dhe se

përballen me rrezik të shpërthimit të ndonjë sëmundjeje.

Numri i viktimave si pasojë e tërmetit të 22 qershorit ka shkuar në 1 150.

Ky tërmet 6.1 shkallësh i Rihterit është kthyer në katastrofën më të madhe



humanitare në Afganistan në dy dekadat e fundit.

Tragjedia është rritur pasi qeverinë e talibanëve nuk e njeh asnjë shtet në botë për shkak të çështjeve të lidhura me të drejtat e njeriut.

Talibanët janë rikthyer në pushtet në gusht të vitit të

kaluar, teksa forcat ndërkombëtare kanë përfunduar misionin në Afganistan.

Zyra e Kombeve të Bashkuara që koordinon çështjet humanitare tashmë ka paralajmëruar për mundësinë e shpërthimit të kolerës.

# Kush i kontrollon thikat në shkolla?



**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Besim Hyseni nuk dëshiron të flasë shumë për humbjen e djalit, por thotë se tragjedi si ajo e tij duhet të parandalohet.

Rijad Hyseni, 14 vjeç, humbi jetën në mars të këtij viti, pasi u ther me thikë në shkollën "Hilmi Rakovica" në Prishtinë. Sulmuesi i dyshuar është i mitur dhe rasti kundër tij është duke u zhvilluar.

Hyseni thotë se Rijadi ka qenë i qetë dhe se nuk ka pasur kurrë probleme me askënd. I rënë nga dhimbja, ai thotë se ka vetëm një thirrje - që prindërit të jenë më të vëmendshëm ndaj fëmijëve të tyre. "Të rrinë më shumë me ta, të flasin më shumë me ta... Le të flasin çdo ditë për atë që kanë bërë në shkollë, me kë kanë biseduar, a kanë pasur ndonjë problem, ku kanë qëndruar pas orarit të mësimet", thotë ai.

Në Kosovë blerja e një thike sulmuese mund të bëhet edhe përmes rrjeteve sociale. Ka faqe publike në "Instagram" me fotografi të produkteve që i ofrojnë dhe me çmimet e poshtëshënuara.

Edhe pse, sipas shënimeve, ato u ofrohen personave mbi 18 vjeç, nuk është e qartë se si

vërtetohet moshë e të interesuarit apo e blerësit eventual.

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar disa administratorë të këtyre faqeve të cilët kanë thënë se të interesuarit i pyesin për moshën, por nuk kanë treguar nëse e konfirmojnë atë dhe si. Lëshime në këtë drejtim duket se ka, së paku në disa raste.

REL ka biseduar me një qytetar nga komuna e Skenderajt i cili ka treguar se vëllai i tij, 12 vjeç, ka blerë thikë përmes një faqeje në "Instagram".

Ledioni - identiteti i vërtetë i të cilit është i njohur për redaksinë e REL-it, e ka porositur thikën online dhe të njëjtën e ka pranuar pas tri ditësh. "E kam parë rastësisht me thikë dhe e kam pyetur: ku e ke marrë? Ai ka refuzuar fillimisht të tregojë, por më vonë më ka treguar për të gjitha detajet", ka thënë vëllai i tij 24-vjeçar. Sipas tij, Ledioni "ka bërë edhe pazar" me shitësin, ndërsa për moshën "nuk e ka pyetur askush". "Vetë vëllai e ka pranuar thikën, kur i ka ardhur me postë. As personat që ia kanë dorëzuar

porosinë nuk e kanë pyetur për moshën", ka thënë vëllai i Ledionit, por nuk është e qartë nëse dorëzuesit e paketës e kanë ditur se çfarë përmban ajo. Sipas vëllait, Ledioni ka thënë se ka dashur të ketë thikë "ashtu sikurse shokët e tij".

Në shkollat e Kosovës dhe ambientet përreth, përveç rastit fatal të Rijad Hysenit, ka pasur këtë vit edhe qindra incidente të tjera që kanë përfshirë përdorimin e thikave. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës për periudhën janar-maj, numri i incidenteve të raportuara në shkolla dhe përreth është 288. "Nga rastet më të shpeshta të raportuara bëhet fjalë për lëndime të lehta trupore, dëmtime prone, vjedhje e të tjera", bëjnë me dije nga Policia e Kosovës për "Radion Evropa e Lirë".

Ata nuk japin detaje nëse dhe si mund të kontrollohet shitja e thikave në internet.

Të premten e 24 qershorit Policia e Kosovës i ka njoftuar mediet se ka kryer një aksion në shkollat në Ferizaj ku, mes të tjerash, ka konfiskuar 40 thika, kryesisht te nxënës të shkollave të mesme.

## Këshilli i Prindërve: Policia duhet të jetë afër shkollave

Kryetari i Këshillit të Prindërve të Kosovës, Jeton Demi, thotë se përdorimi i thikave në shkolla përbën shqetësim të madh njëjtë sikurse përdorimi i substancave narkotike. "Kemi shumë raste kur kontrollohen nxënës në shkolla dhe te ta gjendet ar, thika... Ka pasur raste edhe pistoletë", thotë ai. Për të pasur një siguri më të madhe në shkolla, ai thotë se polica duhet të vendoset në një perimetër të caktuar pranë tyre. "Shqetësimet më të mëdha të prindërve për fëmijët e tyre janë gjatë rrugës për në shkollë dhe kthimit për në shtëpi, si dhe në rrethinat afër shkollave", thotë Demi.

## MASHTI: Në shkolla ekziston protokoli për sigururi

Në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës, të Teknologjisë dhe të Inovacionit në Kosovë pranojnë se çështja e përdorimit të thikave në

shkolla është shqetësuese, por nuk thonë nëse kanë ndonjë plan konkret për adresimin e problematikës në fjalë.

Sipas zyrtarëve të MASHTI-t, në shkolla ekziston protokoli për siguri, që sanksionon dhunën në institucionet arsimore. "Për më tepër - për këtë çështje - instancat e ministrisë kanë kërkuar posaçërisht nga prindërit, por edhe psikologët e shkollave, që të merren më tepër me fëmijët dhe të jenë më të qasshëm në veprimtarinë e tyre, në daljet e tyre në rrugë ose kudo ku shkojnë ata", thotë zëdhënësjë e MASHTI-t, Iliriana Pylla.

Përfaqësues të organizatave që merren me mbrojtjen e fëmijëve thonë se përgjegjësia për fenomenin e thikave në shkolla duhet ndarë midis prindërve dhe institucioneve arsimore. "Ata që furnizojnë me thika janë të fundit në zinxhirin e fajësimit", thotë Florina Duli, drejtoreshë e organizatës "Terre des hommes Kosovo". "Pse oborret e shkollave janë gjithmonë të hapura dhe askush nuk mban përgjegjësi për krimet që ndodhin në ato oborre?", pyet ajo. Sipas saj, ka "shumë fenomene që ndodhin para syve të policisë", por nuk specifikon cilat.

Duli thotë se kontrolli i prindërve, po ashtu, duhet të jetë më i madh pasi, sipas saj, ka fëmijë që shkojnë në shkollë me shuma të mëdha parash. "Ka fëmijë me 500 euro në xhep... Dhe tani ky veprim - të qenët i fuqishëm - e bën pak edhe bullist. Kjo gjë e pandëshkuar ka bërë pastaj që pjesa tjetër të marrë thika për të luajtur rolin e një bullisti apo për ta mbrojtur veten... për të treguar se edhe unë jam i armatosur dhe nuk mund të më kërcënoni", thotë Duli.

Policia e Kosovës ka njoftuar edhe muajin e kaluar për një aksion në disa shkolla të Vushtrisë, ku ka thënë se "ka sekuestruar shtatë thika, një boks hekuri, një pistoletë plastike dhe gjësende të tjera". Gjatë vitit 2021 Policia e Kosovës ka evidentuar gjithsej 413 incidente në shkolla, përfshirë edhe therje me thika.

## Kadetët e FSK-së stërviten përkrah ushtarëve të NATO-s

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka publikuar fotografi të kadetëve të FSK-së, në rrjetin social "Facebook", duke kryer stërvitje përkrah ushtarëve të NATO-s.

Mehaj bëri me dije se këto stërvitje po kryhen në kuadër të kampit veror "Kampi

Veror 2022" i cili po mbahet në shtetin fqinj të Maqedonisë së Veriut. Ai ka shkruar se kjo është një mundësi e shkëlqyer që kadetët e Forcës së Sigurisë së Kosovës t'i rritin shkathësitë e tyre. "Kadetët tanë përkrah kadetëve të vendeve të ushtrive të NATO-s

në stërvitjen 'Kampi Veror 2022' i cili po mbahet në Maqedoninë Veriore. Kjo është një mundësi e shkëlqyer që kadetët tanë, njohuritë dhe shkathësitë e tyre profesionale, t'i zbatojnë në ndërveprueshmëri dhe shpirt ekipor mes trupave shumëkombëshe", ka shkruar Mehaj.





## Tërnovci i Madh “mban peng” përbërjen e Kuvendit të Serbisë

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Përbërja e ardhshme e Kuvendit të Serbisë varet nga një fshat i vogël në jug të këtij vendi. Gati tre muaj pas zgjedhjeve parlamentare, rezultatet nuk dihen ende, për arsye të përsëritjes së votimeve në fshatin Tërnovc i Madh i Bujanocit si pasojë e disa parregullsive. Banorët atje do të dalin sërish në votime më 30 qershor - në përpjekjen e pestë. Nga votat e tyre varet nëse përfaqësuesit e pakicës shqiptare në Serbi do ta fitojnë mandatin e vetëm në Kuvend. Të drejtë vote në vendvotimin në Shkollën Filllore “Muharrem Kadriu” kanë 1 089 votues. Sipas ndarjes së përgjithshme të mandateve, nëse lista e komunitetit shqiptar fiton një mandat, ai mandat do t'i hiqet pastaj Partisë Socialiste të Serbisë (SPS). Për këtë arsye, Shaip Kamberi, i cili udhëheq “Koalicionin e Shqiptarëve të Luginës”, akuzon SPS-në se po tenton ta sabotojë votimin.

Në anën tjetër, Velko Odallovic, anëtar i Komisionit Kryesor të SPS-së, mohon se partia e tij ka bërë përpjekje ta prishë ditën e zgjedhjeve.

### Bomba, provokime dhe konfiskim i listave të zgjedhësve

Në votimin e katërt radhazi, më 23 qershor, ka pasur alarm të rremë për bombë në qendrën e votimit. Kamberi thotë se zgjedhjet nuk kanë filluar atë ditë, sepse “Partia Socialiste e Serbisë, para hapjes së qendrës së votimit, ka bërë përpjekje ta marrë nën kontroll gjithë procesin zgjedhor”. Sipas tij, synimi ka qenë që anëtarët e komisionit zgjedhor nga radhët e “Koalicionit të Shqiptarëve të Luginës” të jenë të pranishëm vetëm si vëzhgues.

“Ne, si pjesëmarrës, nuk kemi mundur të lejojmë nisjen e procesit [zgjedhor]”, thotë Kamberi për Shërbimin e Ballkanit të “Radios Evropa e

Lirë”. Komisionet në vendvotime janë organe të administrimit zgjedhor, që e drejtojnë direkt votimin në një vendvotim, ndërsa vëzhguesit e procesit zgjedhor mbikëqyrin mbarëvajtjen e procedurave në ditën e zgjedhjeve. Kamberi thotë se SPS-ja ka dërguar në Tërnovc të Madh një anëtar të komisionit zgjedhor nga Subotica - në veri të Serbisë - i cili, siç pretendon ky përfaqësues i listës shqiptare, ka provokuar anëtarët e pranishëm të komisionit. “Është e zakonshme që anëtarët e komisionit të jenë njerëz që e njohin terrenin dhe njerëz që mund të kuptohen. Kur dikush vjen nga jashtë, me udhëzime të sakta se çfarë të bëjë, me gjuhë urrejtjeje se ‘kjo është një mbretëri dhe nuk keni asgjë për të kërkuar aty’, atëherë është e qartë se qëllim është provokimi i situatës”, thotë Kamberi. Odallovic, nga SPS-ja, akuzon përfaqësuesit e partive shqiptare për minim të

zgjedhjeve dhe thotë se propozimi i socialistëve ka qenë që procesi zgjedhor të mbikëqyret nga një anëtar i komunitetit shqiptar dhe një serb. “Ka qenë pala shqiptare ajo që i ka marrë listat e votuesve dhe nuk ka dashur të lejojë askënd t’i kontrollojë. Ne kemi qenë dëshmitarë të një përpjekjeje për ta penguar procesin dhe për të mos lejuar fillimin e tij”, thotë Odallovic. Ai shton se akuzat se anëtarë i SPS-së i ka provokuar përfaqësuesit shqiptarë nuk janë të vërteta. Misioni vëzhgues CRTA, i cili ka pasur vëzhgues të pavarur në Tërnovc të Madh, thotë se, përveç alarmit të rremë për bombë, anëtarët e komisionit zgjedhor nuk kanë mundur të pajtohen “për ndarjen e roleve” para votimit.

### Çka tash?

Pavle Dimitrijeviq, zëvendës-drejtor i programit të OJQ-së CRTA, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se shembulli i Tërnovcit

të Madh tregon se puna e dobët e komisioneve zgjedhore është një nga problemet kryesore në procesin zgjedhor në Serbi dhe se CRTA vazhdimisht ka kërkuar që kjo të ndryshojë.

“Qendrat e votimit mund të realizojnë zgjedhje të dobëta, ose të mos i zhvillojnë fare, pa asnjë pasojë apo përgjegjësi. E vetmja pasojë është se në përsëritjet e radhës, ata persona nuk mund të jenë anëtarë të komisionit zgjedhor”, thotë Dimitrijeviq.

### Të gjitha votimet në Tërnovc të Madh

Për partitë e pakicave në Serbi nuk vlen pragu prej 3 %. Për rrjedhojë, këto parti mund të fitojnë mandate në Kuvendin e Serbisë me më pak vota. Sipas vlerësimeve që citohen më së shpeshti, në Serbi jetojnë rreth 60 000 shqiptarë - kryesisht në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, në Serbinë jugore. →

# Asociacioni i Komunave do t'i padisë MASHTI-n dhe MSh-në

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 26 qershor - Në mbledhjen e Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës është vendosur që të nisët procedura për ta paditur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës, të Teknologjisë dhe të Inovacionit dhe Ministrinë e Shëndetësisë për nënshkrimin e kontratave kolektive për arsim dhe shëndetësi pa konsultim e pajtim me komunat derisa zbatim i tyre po bëhet në dëm të buxheteve komunale. Bordi ritheksoi që Asociacioni i Komunave i Kosovës nuk është

kundër kontratave kolektive, por është kundër zbatimit të tyre në formën e deritashme duke ua marrë mjetet financiare komunave kur palë nënshkruese janë institucionet qendrore.

Këto dy kontrata janë nënshkruar pa asnjë konsultim paraprak me komunat, pa vlerësim të ndikimit buxhetor dhe pa dijeninë e komunave, derisa obligimet financiare të tyre kanë rënë tërësisht mbi komunat dhe buxhetet e tyre.

Në kontratat e nënshkruara thuhet se qeveria do të planifikojë buxhet, por që deri më tani asnjëherë as nuk ka

planifikuar e as nuk ka ndarë buxhet për zbatimin e tërësishëm të këtyre dy kontratave.

Asociacioni i Komunave i Kosovës përmes përfaqësuesve në Komisionin e Granteve Komunale edhe këtë vit kërkoi nga qeveria që të planifikohet dhe të ndahet buxhet për zbatimin e këtyre kontratave, por edhe këtë herë kjo kërkesë e AKK-së është refuzuar.

Komunat edhe pse nuk janë nënshkruese të kontratave kolektive po obligohen t'i mbulojnë shpenzimet dhe borxhet që janë krijuar nga nënshkrimi i këtyre kontratave

duke iu krijuar komunave shpenzime të mëdha, përfshirë edhe shpenzimet e procedurave gjyqësore/përmbarimore.

Në anën tjetër, komunat nuk po kanë përkrahje buxhetore për shlyerjen e këtyre obligimeve dhe, si pasojë e neglizhencës së kërkesave të komunave ndaj qeverisë, Zyra Kombëtare e Auditimit me rastin e hartimit të raporteve të auditimit po konstatojnë që komunat po bëjnë keqklasifikim të shpenzimeve buxhetore.

Kostoja financiare për zbatimin e këtyre kontratave është e papërbalueshme nga buxhetet komunale. Kjo praktikë ka

ndikuar dhe është pengesë për mosrealizimin e shumë projekteve kapitale e të cilat projekte ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarit.

Duke marrë për bazë këto fakte, Asociacioni i Komunave të Kosovës do ta paditë Ministrinë e Arsimit, të Shkencës, të Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministrinë e Shëndetësisë përmes padisë së detyrimit.

Me këtë rast, Bordi i Asociacionit i Komunave të Kosovës autorizon drejtorin ekzekutiv të AKK-së, Sazan Ibrahim, për procedim të mëtutjeshëm të kësaj padie.



Në zgjedhjet e parafundit parlamentare në Serbi, në qershor të vitit 2020, partitë shqiptare kanë qenë në një koalicion dhe kanë fituar tri mandate parlamentare. Dy vjet më vonë ato kanë vendosur të garojnë me dy lista - "Koalicioni i Shqiptarëve të Luginës", i udhëhequr nga Shaip Kamberi, dhe "Alternativa për Ndryshim - Alternativa Demokratike Shqiptare", e udhëhequr nga Shqiprim Arifi.

Në deklaratimet e para, pas zgjedhjeve të 3 prillit, të dyja listat zgjedhore kanë thënë se nuk e kanë kaluar pragun dhe se shqiptarët nuk do të kenë përfaqësues në Kuvendin e ri të Serbisë. Megjithatë, më 21 prill, Gjykata Administrative në Nish ka urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në Tërnovc të Madh

për shkak të parregullsisë. Këtu, pastaj, edhe ka filluar seria e përsëritjeve.

Zgjedhjet janë përsëritur për herë të parë më 28 prill. Në këtë ditë kanë votuar 697 nga gjithsej 1 089 votuesit me të drejtë vote - domethënë, pjesëmarrja ka qenë 64 për qind.

Lista zgjedhore "Koalicioni i Shqiptarëve të Luginës" ka fituar më shumë vota: 677. Një gjë e tillë do t'i siguronte asaj një mandat në Kuvendin e Serbisë sikur këto rezultate të mos kontestoheshin.

Kërkesën për përsëritjen e zgjedhjeve e ka paraqitur përfaqësuesi i listës së Partisë Socialiste të Serbisë, Ivica Daçiç. Pasi SPS-ja është ankuar se ka votuar edhe një votues që nuk ka pasur dokumente të vlefshme personale, Komisioni

Republikan i Zgjedhjeve ka urdhëruar një votim të ri.

Zgjedhjet në Tërnovc të Madh janë mbajtur sërish më 27 maj. Atë ditë kanë votuar 618 nga 1 089 votues me të drejtë vote.

Rezultatet kanë qenë ndryshe nga hera e mëparshme. "Koalicioni i Shqiptarëve të Luginës" ka fituar këtë herë 598 vota. Atij i janë dashur edhe 12 vota për ta kaluar pragun dhe për ta fituar mandatin parlamentar.

"Koalicioni i Shqiptarëve të Luginës", më pas, ka kontestuar votimin, duke thënë se një person është lejuar të votojë pa letërnjoftim.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve e ka hedhur poshtë ankesën, por Gjykata Administrative ka urdhëruar votim të ri.

## Lufta për një mandat

Për të hyrë në Kuvendin e Serbisë, "Koalicionit të Shqiptarëve të Luginës" i nevojiten 610 vota në vendvotimin numër gjashtë në Tërnovc të Madh, me kusht që SPS-ja të mos marrë asnjë votë, pasi kjo do ta rriste pragun zgjedhor.

Në atë rast, socialistët do të humbnin një mandat në Kuvend dhe do t'i kishin 31 deputetë, ndërsa një mandat do t'i takonte koalicionit shqiptar.

"Nuk e di se përse është kaq e rëndësishme për SPS-në,

sepse i ka 31 mandate... Pse tani, kur nuk kanë vota, përpiqet kaq shumë që të na pamundësojë atë një deputet? Është e paqartë për mua", thotë Kamberi.

Odalloviq, në anën tjetër, thotë se SPS-ja këmbëngul që procesi zgjedhor në Tërnovc të Madh të përfundojë në mënyrë të ligjshme.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar më 20 qershor se për të nuk është plotësisht e qartë se çfarë po ndodh me zgjedhjet në Tërnovc të Madh.

# Përdoruesit e drogave trajtohen në Psikiatri, Kosova s'ka institut për trajtimin e varësisë

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Në vetëm gjashtë shtretër sa ka një repart i Psikiatrisë, po trajtohen përdoruesit e substancave narkotike.

Personat me sëmundje të varësisë trajtohen në vendin e njëjtë me ata që kanë çrregullime mendore.

Gjatë këtij viti janë regjistruar 60 pranime. Trajtimi i tyre ka zgjatur më shumë se 800 ditë. Për shkak të numrit të vogël të kapaciteteve, shumë herë pacientët trajtohen edhe në repartet ku nuk janë të paraparë për ata.

Kosova nuk ka Institut për Trajtimin e Sëmundjeve të Varësisë.

Në kuadër të Klinikës Psikiatrike është një repart i veçantë, në të cilin po trajtohen personat me sëmundje të varësisë. Kjo klinikë ka edhe katër reparte të tjera, por ajo ku trajtohen këto raste ka kapacitete më të vogla.

Drejtori i Klinikës Psikiatrike, Faton Kutlovci, për "Kosovapress" tregon se ka rritje të numrit të rasteve të përdoruesve të drogave

që kërkojnë trajtim. "Në kuadër të repartit për sëmundje të varësisë janë vetëm gjashtë shtretër. Nëse marrim në konsideratë nevojat e shtuara, sidomos vitet e fundit, po flas për vitin e fundit sepse në qoftë se ju intereson një trend i numrit të atyre që kanë kërkuar ndihmë në klinikën tonë, atëherë numri më i madh ka qenë gjatë vitit 2019, pastaj ka shënuar një rënie gjatë viteve të pandemisë 2020-2021 dhe ka shënuar rritje tani gjatë vitit 2022. Deri më tani kemi të 812 ditë trajtimi, 60 pranime dhe kjo na paraqet telashe. Për shkak se i kemi vetëm gjashtë shtretër, ka kërkesa shumë të mëdha", tregon ai.

Numër i madh i kërkesave për trajtim të detyrueshëm vijnë nga gjykatat. Personat e pranuar qëndrojnë deri në dhjetë ditë për detoksifikim. "Jemi të detyruar shpeshherë t'i trajtojmë këta pacientë në reparte të tjera, për shembull, në repartin A, ku trajtohen personat me çrregullime



mendore ose çrregullime psiotike, sepse edhe pacientët që abuzojnë me substanca psikoaktive, krahas edhe ankesave të tjera, ne nuk kemi një institucion me kapacitete më të mëdha. Më mirë me thënë, Kosova ka shumë nevojë për

institut për trajtimin e sëmundjeve të varësisë, sepse nevojat janë në rritje", ka thënë Kutlovci.

Ai shton se ndërtimi i Institutit për Trajtimin e Sëmundjeve të Varësisë duhet të jetë strategji kombëtare. Nevojën për

ndërtimin e këtij instituti e konsideron të domosdoshme Safet Blakaj, i cili është drejtor i Qendrës Specialistike Psikiatrike "Labyrinth" në Prishtinë.

Safet Blakaj, drejtor i Qendrës Specialistike Psikiatrike

"Labyrinth", ka thënë se patjetër është e nevojshme një institucion jashtë objektit të Klinikës Psikiatrike, në të cilin përdoruesit e drogave do të merrnin shërbimet e tyre më specifike.

"Nuk do të thosha që do të duhej të ishte për numër të madh të pacientëve por, sido që të jetë, të jetë qendër referente për trajtimin e përdoruesve të drogave, por edhe për përcjelljen e gjendjes së situatave të përdorimit të drogave në Kosovë", shprehet Blakaj.

Qendra nuk ofron shërbim 24 orë, por shërbime mjekësore, vizita psikiatrike e përkrahje psiko-sociale. Në gjashtë muajt e parë të këtij viti është regjistruar rritje e numrit të përdoruesve të drogave.

## Abdixhiku në Gjenevë: Kosova sot është peng i popullizmit



PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka zhvilluar takime me struktura dhe veprimtarë të LDK-së si dhe me bashkatdhetarë të shumtë në Gjenevë.

Para të pranishmëve të shumtë, në fjalën e tij hyrëse, Abdixhiku tha se nuk është e rastësishme që në kaq kohë të shkurtër takohen bashkë dy herë në Zvicër, ndërkaq shtoi se kjo është shenjë e një lidhje e besëlidhje që i mbijeton kohës. "LDK-ja dhe mërgata shqiptare janë një familje, janë një shtëpi. Ne as nuk jemi mysafirë në shtëpinë

tonë gjeografike, as nuk jeni mysafirë në shtëpinë tuaj politike. Kurdo që shihemi e takohemi sërish, pavarësisht prej sfidave nëpër të cilat kemi kaluar të dy, ne mbesim një shtëpi", nënvizoi kryetari Abdixhiku, thuhet në njoftimin për medie.

Ndër të tjera, Abdixhiku rikthimin e lidhjes me mërgatën e konsideroi si të domosdoshme e të përhershme ngaqë, sipas tij, për LDK-në mërgata është pasuri kombëtare, për të cilën tha se e tillë ka qenë dhe do të jetë përherë.

Pasi që e vlerësoi maksimalisht rolin e mërgatës në të gjitha etapat

që ka kaluar Kosova, Abdixhiku para të pranishmëve tha se shumë kemi arritur në këto 32 vjet, ndërsa shtoi se sërish kemi shumë për të bërë drejt projektit tonë përfundimtar. "Lirinë, pavarësinë, demokracinë e vendit tonë duhet ta ankorojmë në Evropë. Të rinjve e të rejave tona, familjeve në Kosovë, duhet t'u japim një shtet euroatlantik. Siç e kemi menduar në ditën e parë 32 vjet më parë, siç po e kërkojmë sot, siç do ta bëjmë nesër ne", theksoi kryetari Abdixhiku dhe shtoi se ashtu siç LDK-ja dhe mërgata i kanë bërë bashkë lëvizjet e mëdha

gjeopolitike në Kosovë, bashkërisht edhe do ta ankorojnë Republikën e Kosovës, projektin e Ibrahim Rugovës, në BE e në NATO.

Sa i përket qeverisjes aktuale, kryetari Abdixhiku tha se Kosova sot është peng i popullizmit, përkatësisht peng i politikanëve që për një kohë të gjatë kanë qenë në rol dhe atë në rol të madh mashtrimi, të cilët kanë ndërtuar kauza fiktive dhe, ndaj nuk mund të japin zgjidhje historike sot. "Popullizmi nuk sjell çmime të përballueshme, nuk sjell vende të punës, nuk sjell cilësi në shërbime, nuk sjell as arsim, as shëndetësi, as

mirëqenie të qëndrueshme", tha Abdixhiku.

Ai shtoi se e kemi obligim të ri për veten dhe qytetarët tanë në hall që të japim një program të fuqishëm e përparimtar dhe një ekip që implementon pa frikë, pa paranojë, pa demagogji, projektin e zhvillimit të vendit tonë.

Në fund të fjalës së tij, kryetari Abdixhiku nënvizoi se, duke qenë bashkë në lidhjen e së ardhmes, patriotë, rugovistë, të djathtë, e secili i ri e i vjetër pa dallim, do t'i japim atdheut tonë shpresën e kërkuar kaheër, duke udhëtuar së bashku drejt stacioneve të së ardhmes.

# Projekti që mund ta përtafrojë ekonomikisht Kosovën e Shqipërinë

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Nëse realizohet projekti për ndërtimin e një porti të thatë në Prishtinë, që do të lidhë me Portin e Durrësit, Kosova dhe Shqipëria do të përfitonin shumë ekonomikisht. Ato "do të operonin si një lloj sistemi i përbashkët doganor" dhe "nuk do të kishte më prani doganore mes dy vendeve", thotë ish-drejtori i Doganave të Kosovës, Naim Huruglica. "Procedurat që do të kryheshin në Kosovë do t'i plotësonin ato në Shqipëri dhe anasjelltas", sqaron ai. Rrjedhimisht, do të ulëshin kostot doganore dhe do të zvogëlohej koha e pritjes në pika të dyfishta. Projekti, në fakt, parashihet ndërtimin e dy porteve të reja tregtare: Porto Romano në Durrës dhe Porti i Thatë në Prishtinë.

Lidhja midis tyre do të bëhet përmes hekurudhës Durrës - Prishtinë.

Projekti është paraqitur në mbledhjen e përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë e cila është mbajtur më 20 qershor në Prishtinë.

Sipas udhëheqësve të të dyja shteteve, projekti synon ta transformojë infrastrukturën e zhvillimit tregtar dhe të marrëdhënies tregtare midis Kosovës dhe Shqipërisë, por edhe më gjerë. "Për këtë [projekt], çdo ditë do të bëj fushatë", ka thënë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Sipas kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, realizimi i këtij projekti do ta vendoste Shqipërinë dhe Kosovën "në qendër të një graviteti rajonal", ndërsa Durrësin do ta

bënte "një nga portet më strategjike ekonomike të Mesdheut".

Sipas prezantimit të bërë nga Eric Smit, drejtor i kompanisë holandeze "Royal Haskoning", e cila ka bërë projektin, porti i thatë në Prishtinë do të shfrytëzohet për zhdoganimin e mallrave, gjë që do ta lehtësonte pastaj ngarkesën në portin detar të Durrësit.

Porti i thatë është parashikuar të ketë një terminal, ku do përpunohen 100 mijë kontejnerë deri në vitin 2050. "Porti i thatë jep shumë mundësi dhe është një infrastrukturë ideale për ta hequr stresin nga portet detare. Kjo i lehtëson disa pjesë shumë thelbësore të portit detar", ka thënë Smit.

Projekti i investimit në Porto

Romano llogaritet se do të ketë ndikim pozitiv në brutoprodhimin e brendshëm të Shqipërisë, nga 3 % deri në 6 %, ndërsa për Kosovën ende nuk ka një përlogaritje të saktë.

Porto Romano do të ketë një sipërfaqe prej 400 hektarësh, me kapacitet prej 2 milionë kontejnerësh deri në 50 milionë tonelata.

Afat për realizimin e projektit nuk ka dhe Smit ka thënë se duhet fillimisht një studim i fizibilitetit.

Sfidë, me sa duket, mund të paraqesë transporti i dobët hekurudhor i Kosovës si për nga infrastruktura, ashtu edhe për nga mënyra e operimit.

Tash për tash trenat e Kosovës kryesisht qarkullojnë në vetëm dy linja: Prishtinë - Han i Elezit dhe

Prishtinë - Pejë.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, sasia e mallrave të transportuara me tren në tremujorin e parë të vitit 2022 ka qenë rreth 114 mijë tonë, ndërsa numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi në këtë periudhë ka qenë rreth 13 mijë.

Hekurudha e Kosovës është e izoluar dhe nuk ka asnjë linjë ndërkombëtare. E vetmja linjë rajonale që ka funksionuar deri vonë ka qenë ajo me Shkupin në Maqedoni të Veriut por, prej vitesh, as kjo linjë nuk është funksionale.

Para luftës së viteve 1998/99 qytetarët kanë shfrytëzuar hekurudhat e Kosovës për në shumë vende perëndimore, pasi trenat e Kosovës kanë qenë të lidhur me linjat ndërkombëtare.



## Rukiqi: Qeveria Kurti po heziton ta pranojë krizën ekonomike në Kosovë

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka deklaruar se i shqetëson neglizhenca e institucioneve për ta trajtuar në mënyrë më serioze krizën që e ka prekur krejt botën, përfshirë edhe vendin tonë. E derisa ka folur për inflacionin, ka shtruar pyetjen se çfarë nëse shkon në stagflacion.

Rukiqi, po ashtu, ka folur rreth sfidave me të cilat po ballafaqohen bizneset, bashkëpunimin me institucionet, çështjen e çmimeve të naftës dhe marrëveshjet në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

I pyetur për gjendjen aktuale në të cilin po kalon vendi me ngritje të inflacionit, i cili tashmë është



11.2 për qind, Rukiqi ka thënë se qeveria aktuale e drejtuar nga Albin Kurti nuk është duke e pranuar se vendi është në gjendje jo të mirë ekonomike. Sipas tij, qeveritë e vendeve të tjera dhe bizneset janë ulur së bashku për t'i diskutuar problemet e këtyre të fundit, por kjo nuk ka ndodhur edhe në vendin tonë, gjë që mund të krijohen dëme të pariparueshme. "Neve po na shqetëson pak neglizhenca e institucioneve për ta trajtuar në mënyrë më serioze këtë krizë. Për ta adresuar një krizë fillimisht duhet pranuar që ka krizë. Ka pak hezitim të qeverisë për ta adresuar si krizë. Unë mendoj që kjo është natyra e problemit, pastaj te specifikat e problemit apo si mund të trajtohet një krizë,

ka shumë mekanizma. Në radhë të parë do të ishte një mekanizëm mes sektorit privat dhe qeverisë për të diskutuar në baza të rregullta këtë çfarë po ndodh dhe kjo po bëhet praktikë në të gjitha vendet, ulen kompanitë, ulen aktorët e rëndësishëm të tregut, ulen shoqatat e bizneseve, qeveria dhe diskutojnë modalitetet se si mund të dilet nga një situatë e cila mund të krijojë dëme të pariparueshme. Tani për tani është inflacion, po çfarë nëse shkon në stagflacion e pastaj edhe në vende pune", tha ai. Rreth rritjes së çmimit të naftës Rukiqi ka deklaruar se fajtor për këtë nuk janë bizneset, ashtu siç po thuhet nga qeveria por, sipas tij, fajtor për këtë është importi me rritje të çmimit.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Morina: Udhëtojmë për fitore në Danimarkë

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kosova më 30 qershor luan ndeshjen në udhëtim ndaj Danimarkës e cila zhvillohet në kuadër të FIBA EuroBasket Pre-Qualifiers. Rreth synimeve ka folur basketbollisti (qendra) Gëzim Morina. "Natyrisht që në Danimarkë udhëtojmë me të vetmin synim fitore. Jemi të vetëdijshëm që Danimarka ka një

ekip mjaft të mirë. Sipas të gjitha gjasave do të jetë një ekip krejt tjetër nga ai që kemi luajtur në Prishtinë sepse në lojën e parë më Danimarkën kanë pasur mjaft mungesa, por ne do ta bëjmë më të mirën dhe shpresoj që të kthemi nga Danimarka me fitore", ka thënë Morina për faqen zyrtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Morina ka folur edhe për mangësitë dhe përparësitë që sipas tij do t'i kemi në këtë ndeshje: "Padyshim që Danimarka ka lojtarë të mirë, lojtarë të cilët paraqiten edhe në EuroLigë dhe në liga të tjera Evropiane. Si përparësi e jona është që jemi më pak shtatë shkurt të cilën duhet ta shfrytëzojmë kundrejt tyre dhe të luajmë lojë më të shpejt".



Gëzim Morina

## Kosova fiton medalje në Kampionatin Ballkanik



PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kosova ka fituar medalje në Kampionatin Ballkanik të Beach Volley për herë të parë në histori. Dyshja kosovare Dhuratë Sylejmani/Valmira Ramadani - e drejtuar nga trajneri Edon Ibrahimimi kanë arritur të shkruajë historinë e Kosovës në Kampionatin Ballkanik të volejbollit

në rërë, duke u bërë ekipi i parë senior që fiton medalje në këtë kompeticion, i cili u zhvillua në Balikesir të Turqisë. Në finale, vashat "dardane" u mposhtën nga dyshja nga Turqia 1, Gokalp/Merve me rezultat 2-0 në sete. Kosova, kështu, siguron vendin e dytë dhe medaljen e argjendtë në një Kampionat Ballkanik të Beach Volley

